

Paketë orientuese për të punuar në MB

E drejta për të punuar në MB

Nëse nuk jeni shtetas britanik, duhet të vërtetoni se keni të drejtë të punoni në MB. Punëdhënësit mund të gjobiten ose madje të përballen me burgim nëse punësojnë dikë në mënyrë të paligjshme.

Ekzistojnë më shumë se 20 lloje vizash pune specifike në MB dhe lista e tyre përditësohet rregullisht. Përdorni [këtë shërbim në internet](#) për të zbuluar nëse keni vizën e duhur për të punuar në MB.

Klikoni në foto ose lidhje për informacion më të detajuar

Vërtetimi i të drejtës për të punuar




Nëse ju është thënë se mund ta shikoni statusin tuaj të imigracionit në internet, mund të merrni një [kod bashkëndarjeje](#) për të vërtetuar të drejtën tuaj për të punuar në MB. Kodi është i vlefshëm për 30 ditë dhe mund t'u dërgohet punëdhënësve, të cilët më pas mund të kontrollojnë:

- Llojin e punës që ju lejohet të bëni
- Sa kohë mund të punoni në MB
- Nëse keni kërkesa për përfitime ose keni akses në shërbimet shëndetësore të NHS-së
- Nëse mund të hapni një llogari bankare

Ju mund të hapni kodin e bashkëndarjes nëpërmjet [uebsajtit të qeverisë](#). Ju duhet pasaporta ose karta e identitetit, leja biometrike e qëndrimit (BRP) ose viza dhe numri i kartës biometrike të qëndrimit.

Çfarë është Numri Kombëtar i Sigurimit?



NINO do të thotë "Numri Kombëtar i Sigurimit" dhe është një numër referencë për pagimin e taksave, sigurimeve dhe kërkit të përfitimeve.

Qytetarët britanikë pajisen me NINO në moshën 16 vjeç. Edhe refugjatëve u jepet një NINO. Megjithatë, kjo nuk vlen për të gjithë ata që kanë të drejtë të punojnë, kështu që mund t'ju duhet të [aplikoni për një numër](#).

Ju mund të filloni punë pa NINO, por ai do t'ju duhet për të siguruar që kontributet e sigurimit kombëtar dhe taksat që paguani të regjistrohen saktë në emrin tuaj. Kjo mund të zgjasë deri në 16 javë, kështu që ia vlen ta bëni këtë sa më shpejt të jetë e mundur.

Lista e profesioneve me mungesë të fuqisë punëtore

[Lista e profesioneve me mungesë të fuqisë punëtore](#) është një listë e vendeve të punës ku bizneset dhe punëdhënësit në Mbretërinë e Bashkuar përballen me mungesë punëtorësh.

Në përgjithësi, personat që kërkojnë azil nuk lejohen të punojnë, por, nëse kërkesa e tyre mbetet e pazgjidhur pas 12 muajsh jo për fajin e tyre dhe ata janë të kualifikuar siç duhet, kanë të drejtë të aplikojnë për punë në listën e



profesioneve ku ka mungesë.

Ju duhet të aplikoni me shkrim pranë Departamentit të Vizave dhe Emigracionit në Mbretërinë e Bashkuar për të drejtën për të punuar në këto punë.

Shërbimi i Zbulimit dhe Ndalimit



Në shumë pozicione pune në MB kërkohet kontrolli i historikut të precedentëve penalë. Këto zakonisht përfshijnë punën me fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

[Shërbimi i Zbulimit dhe Ndalimit](#) (DBS) është një mënyrë që punëdhënësit të kontrollojnë nëse keni precedentë penalë. Kontrollat mund të bëhen vetëm brenda MB-së. Nëse nuk keni jetuar në MB për 5 vitet e fundit, mund t'ju duhet të aplikoni për një "Vërtetim të karakterit të mirë" nga vendi juaj. Procesi i aplikimit ndryshon [sipas vendit](#).

Mund ta keni të vështirë t'i merrni këto të dhëna nga vendi juaj, prandaj mund të flisni me punëdhënësit për kontrole alternative, si p.sh. referenca shtesë mbi karakterin. Gjithashtu, mund të ofroni të bëni një "betim" para një përfaqësuesi ligjor.

Disa dënime penale konsiderohen "të shlyera" dhe nuk kanë nevojë të deklarohen. Megjithatë, rregullat janë të komplikuar, kështu që nëse keni një dënim penal, është mirë të kërkonit këshilla nëse ju pyet punëdhënësi.

Pikat kryesore

1. Është e paligjshme të punosh në MB pa dokumentacionin e duhur
2. Punëdhënësit duhet të kërkojnë një kod bashkëndarjeje për të kontrolluar nëse kualifikoheni për të punuar
3. Ju duhet të aplikoni për një numër kombëtar të sigurimit për të punuar ose për të kërkuar përfitime
4. Në shumë pozicione pune në MB kërkohet dëshmi penalteti, e quajtur DBS

Lidhje dhe burime të dobishme

- [Citizen's Advice](#) ka shumë informacione dhe këshilla të qarta dhe të lehta për t'u kuptuar lidhur me dokumentet e ndryshme që mund të dorëzoni në varësi të statusit tuaj të imigracionit.
- Lista e përditësuar e [vizave aktuale të punësnë MB](#)
- Çfarë janë kontributet e [sigurimit kombëtar](#)?
- Projekti i Drejtësisë së Migracionit ka hartuar një [udhëzues](#) për të ndihmuar personat që kërkojnë azil të kuptojnë se si dhe nëse mund të aplikojnë për leje për të punuar ndërkohë që kërkesa e tyre është në pritje.
- Një listë e [vendeve nga A te Z](#) dhe procesi i aplikimit për kontrollet e precedentëve penalë jashtë shtetit

- Udhëzimi i qeverisë për [betimin](#) dhe referencën e karakterit për personat që aplikojnë për leje SIA, e cila kërkohet për të punuar në shërbimet e sigurisë.
- Nëse keni një precedent penal, [Unlock](#) mund të ofrojë informacion, këshilla dhe mbështetje.

Paketë orientuese për të punuar në MB

Llojet e punësimit

Punësimi zakonisht ndahet në një nga tre kategoritë e mëposhtme:

Spektori privat – përbëhet nga kompani dhe biznese që sjellin fitime për pronarët e tyre. Ato financohen nëpërmjet shitjes së mallrave dhe shërbimeve, Shembuj të tyre janë dyqanet, hotelet, magazinat dhe fabrikat.

Spektori publik – përbëhet nga organizata që menaxhohen nga qeveria. Ato ofrojnë shërbime në dobi të komunitetit dhe paguhen me anë të taksave. Përfshihen shkollat, spitalet dhe këshillat vendore.

Spektori vullnetar – ky njihet edhe si "sektori i tretë" dhe përfshin organizata bamirëse, grupe komunitare, sipërmarrje sociale dhe grupe të tjera që nuk nxjerrin fitime.

Klikoni foton ose lidhjen për informacion të detajuar

Cili është statusi juaj i punësimit?



Të drejtat tuaja të punës varen nga [statusi juaj i punësimit](#).

Ju jeni **punëmarrës** nëse punëdhënësi juaj ofron punë të rregullt, ju thotë se kur dhe ku duhet të kryhet ajo. **Punëtorit** nuk i jepen orë të rregullta ose të garantuara pune nga punëdhënësi, si për shembull stafit të përkohshëm ose punëtorëve sezonalë.

Në të dyja rastet, punëdhënësi paguan taksat dhe sigurimin kombëtar në emrin tuaj dhe ju gëzoni të drejtat bazë të punësimit, të tilla si leja vjetore e paguar dhe paga minimale. Nëse punoni me kohë të pjesshme, keni të njëjtat të drejta si një punëtor me kohë të plotë.

Më shumë informacion mund të gjeni në [Seksioni E – Të drejtat tuaja në punë](#)

Agjencitë e rekrutimit dhe punësimit



Agjencitë e rekrutimit punojnë në emër të punëdhënësve për të gjetur kandidatë të përshtatshëm për të plotësuar vendet e tyre të lira. Një agjenci rekrutimi **nuk** duhet të kërkojë **kurrë** tarifë nga ju për t'ju gjetur një punë.

Disa agjenci rekrutimi gjejnë staf për biznese të tjera, por e paguajnë vetë stafin. Ato njihen si biznese punësimi. Në këtë rast do të jeni [punonjës i agjencisë](#). Kjo ndodh shpesh në sektorë të tillë si industria përpunuese dhe magazinimi.

Kontratat e punës



Kur ju ofrohet një punë, punëdhënësi juaj **duhet** t'ju japë një "deklaratë me shkrim të specifikave të punësimit", që shpesh quhet [kontrata e punës](#). Kjo është një marrëveshje ligjore që përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja. Edhe punonjësve të agjencisë duhet t'u jepet një deklaratë me shkrim e specifikave të punësimit dhe të gëzojnë të drejtat themelore të punës që nga dita e parë.

Kontratat e përhershme nuk kanë një datë të caktuar për përfundimin e marrëdhënies së punës. Kontratat me afat të caktuar ose të përkohshme

	<p>kanë një datë të caktuar për përfundimin e marrëdhënies së punës. "Kontrata me orë zero" i referohet një marrëveshjeje ku nuk ka orë minimale të përcaktuara pune.</p>
<p>Praktikat</p> 	<p>Praktika është një lloj punësimi me pagesë ku punonjësi shpenzon një pjesë të kohës së tij duke u trajnuar, gjë që çon në një kualifikim që njihet në nivel kombëtar.</p> <p>Shumë njerëz mendojnë se praktikantët janë vetëm për të rinjtë, por mund të aplikojnë për një praktikë persona të çdo moshe, njësoj si në çdo punë tjetër. Megjithatë, paga minimale për një praktikant është shumë më e ulët se në punët e tjera.</p> <p>Programet e praktikës financohen nga qeveria, kështu që disa grupe migrantësh mund të mos kenë akses në këtë lloj pune.</p> <p>Mund të mësoni më shumë rreth praktikave dhe të shfletoni mundësitë pranë jush në uebsajtin e qeverisë.</p>
<p>Vetëpunësimi</p> 	<p>Personat e vetëpunësuar zotërojnë kompaninë ose biznesin e tyre dhe janë përgjegjës për mënyrën dhe oraret e punës. Ata i paguajnë vetë taksat dhe kontributet e sigurimit kombëtar. Ata nuk kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi pune si punonjësit apo punëtorët. Nëse jeni i vetëpunësuar dhe fitoni mbi 1000 paund në vit, duhet të regjistroheni në Departamenti i Shtetit për Mbledhjen e Taksave (HMRC) për qëllime tatimore.</p> <p>Ju mund të jeni punëtor/punonjës i një kompanie, por gjithashtu të drejtoni biznesin tuaj dhe të jeni i vetëpunësuar në të njëjtën kohë.</p>

Pikat kryesore

- 1. Të gjithë punëdhënësit, duke përfshirë agjencitë, kanë përgjegjësinë ligjore që t'ju japin një deklaratë me shkrim të kushteve tuaja në punë.**
- 2. Nëse jeni punëtor ose punonjës, ju gëzoni të drejtat themelore të punës. Kjo vlen edhe nëse punoni për një agjenci ose keni një kontratë me kohë të pjesshme, të përkohshme ose me orë zero.**

Lidhje dhe burime të dobishme

- Qeveria publikon [statistikat mujore](#) që përfshijnë informacione për numrin e personave të punësuar dhe vendet e lira të punës.
- Ky [udhëzues](#) jep një pasqyrë të ndryshimeve midis sektorit publik dhe privat në MB, si dhe avantazhet/disavantazhet e punës në secilin sektor.
- Instituti i Autorizuar i Personelit dhe Zhvillimit ka më shumë [informacion](#) se çfarë duhet të përmbajë një kontratë pune.
- Informacion rreth rregullave për [agjencitë e punësimit](#)
- Ky është një [udhëzues për vetëpunësimin](#) nga Grupi i Reformës në Tatimin mbi të

Ardhurat e Ulëta, i cili gjithashtu përmban informacione për të kuptuar nëse jeni i [i punësuar apo i vetëpunësuar](#)

Paketë orientuese për të punuar në MB



Si të gjeni dhe të aplikoni për një punë





Shumica e vendeve të lira të punës gjenden në internet. Kjo do të thotë që ju duhet të dini të përdorni kompjuterin. Megjithatë, mund të trokitni në derën e punëdhënësve vendas për të pyetur nëse kanë ndonjë vend të lirë pune.


Ka shumë këshilla dhe informacione se si të aplikoni për punë. Ky seksion ofron informacion bazë.

Në fund të këtij seksioni do të gjeni një listë të uebsajteve me këshilla të shkëlqyera si të shkruani CV dhe letra motivimi.

Klikoni foton ose lidhjen për informacion të detajuar

<p>Uebsajte të kërkimit për punë</p> 	<p>Ka qindra faqe të ndryshme pune, ose uebsajte punësimi, ku mund të gjeni vende pune të shpallura. Mund të gjeni një listë të atyre që përdoren më shpesh këtu me disa këshilla se si të zgjidhni më të mirën për ju. Agjencitë e rekrutimit përdorin shpesh faqet e punës në internet.</p> <p>Ka disa faqe që specializohen në profesione ose sektorë të caktuar pune. CharityJob është një shembull i faqes që përdoret gjerësisht nga sektori i tretë.</p> <p>Shumë kompani kanë faqe në uebsajtin e tyre, ku shpallin vendet e lira të punës dhe ju mund të aplikoni drejtpërdrejt në faqen e tyre. Kjo është më e zakonshme me bizneset e mëdha, kështu që, nëse i njihni kompanitë kryesore që punojnë në industrinë tuaj, duhet të regjistroheni në faqet e tyre për përditësime.</p>
<p>Rrjetëzimi</p> 	<p>Rrjetëzimi është i rëndësishëm dhe shumë njerëz gjejnë punë përmes miqve, familjes dhe ish-kolegëve. Kjo është shumë më e vështirë nëse nuk i keni ato rrjete në MB, megjithatë, ka mënyra për t'i krijuar ato.</p> <p>Ja vlen të dërgoni CV-në tuaj dhe letrën e motivimit te bizneset e vogla dhe të mesme për të pyetur për vende të lira pune. Këto kompani jo gjithmonë kanë Burime Njerëzore të dedikuara, kështu që vendet e lira nuk shpallen gjithmonë. Edhe nëse nuk kanë asgjë për momentin, kjo është një mënyrë për të filluar bisedën dhe ata do t'ju kenë parasysh nëse ka diçka në të ardhmen.</p> <p>LinkedIn është faqja më e njohur e rrjetëzimit në internet për profesionistët që kërkojnë punë. Këtu jepen disa këshilla të mira se si ta përdorni në dobinë tuaj kur kërkon punë.</p>
<p>Aftësitë e transferueshme</p>	<p>Aftësitë e transferueshme janë aftësitë që përdorni në çdo punë. Disa janë të lehta për t'u përshkruar në një aplikim për punë, për shembull aftësitë në menaxhim projektsh dhe në teknologji informacioni. Aftësi të tjera të transferueshme përfshijnë krijimin e marrëdhënieve dhe vëmendjen ndaj detajeve.</p> <p>Aftësitë e transferueshme konsiderohen shumë të rëndësishme në MB.</p>

	<p>Punëdhënësit besojnë se një person me aftësi të transferueshme përshtatet me ndryshimin e vendeve të punës. Shumë përshkrime pune listojnë një sërë aftësish që kërkon kompania. Mund të mos i keni të gjitha aftësitë e kërkuara, por aftësitë tuaja të transferueshme mund të jenë shumë të ngjashme.</p>
<p>CV dhe letra e motivimit</p> 	<p>CV-ja, ose jetëshkrimi, është një dokument që pasqyron arsimimin, aftësitë, përvojën dhe historikun tuaj të punësimit. Nuk ka ndonjë mënyrë të saktë apo të gabuar të shkrimit të një CV-je, por ka disa rregulla bazë që duhet të ndiqni.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni një strukturë të qartë • Shkruani shkurt • Shmangni gabimet • Përshtateni me pozicionin e punës <p>Çfarë nuk duhet të përfshini në CV-në tuaj</p> <ul style="list-style-type: none"> • Adresë joprofesionale emaili • Fotografi • Detaje personale
<p>Formularët e aplikimit</p> 	<p>Punëdhënësit nuk kërkojnë gjithmonë CV. Ndonjëherë ata do t'ju kërkojnë të plotësoni një formular aplikimi, i cili zakonisht gjendet në internet. CV-ja juaj do të jetë e dobishme, sepse prej saj mund të merrni pjesën më të madhe të informacionit.</p> <p>Kur plotësoni një aplikim për punë ka gjithmonë një seksion që ju kërkon të shpjegoni më shumë rreth aplikimit tuaj. Këtu kërkohen më shumë detaje sesa në një letër motivimi.</p> <p>Vendet e lira të punës zakonisht shpallen me një seksion përshkrim të punës dhe specifikime për personin, të cilat tregojnë se çfarë përfshin puna dhe një listë të aftësive, njohurive dhe përvojës që kërkohen për të bërë punën.</p> <p>Kur të plotësoni këtë pjesë, përgjigja juaj duhet të jetë në përputhje me këtë listë dhe të jepni shembuj, nëse është e mundur.</p> <p>Zakonisht ka një afat për të aplikuar për një vend pune. Mos e lini deri në minutën e fundit!</p>
<p>Intervista</p> 	<p>Intervistat e punës mund të zhvillohen ballë për ballë, në telefon ose nëpërmjet videokonferencave.</p> <p>Duhet të përgatiteni paraprakisht për intervistën dhe të kërkonit sa më shumë për kompaninë dhe pozicionin e punës.</p> <p>Ka disa pyetje që punëdhënësit i bëjnë zakonisht, kështu që mund të praktikoni përgjigjet tuaja për to. Ja disa shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mund të na thoni diçka për veten tuaj? • Pse doni të punoni këtu? • Cilat janë pikat tuaja të forta dhe të dobëta?

	<ul style="list-style-type: none"> • Si e menaxhoni punën tuaj? • A mund të më jepni një shembull se kur ju është dashur të përballeni me një situatë të vështirë? <p>Në fund të intervistës mund t'ju pyesin nëse keni ndonjë pyetje. Kujdesuni që pyetjet tuaja të jenë të përshtatshme. Mund të pyesni për mundësitë e trajnimit ose kulturën e përditshme të punës.</p>
<p>Referencat</p> 	<p><u>Referencat</u> janë persona që mund të flasin për përvojën tuaj të punës, aftësitë dhe karakterin tuaj. Shumica e punëdhënësve kërkojnë dy referenca, njëra prej të cilave duhet të jetë nga shefi juaj i fundit. Një shef mund të flasë për aftësitë tuaja të transferueshme, për shembull se jeni i organizuar dhe i zgjidhni mirë problemet.</p> <p>Dhënia e këtij informacioni mund të jetë e vështirë për disa persona të sapoardhur në MB. Nëse referencat e punës janë të gjitha nga jashtë vendit, mund të përfshini një që mund të flasë anglisht.</p> <p>Referencat e karakterit mund të jenë nga kushdo që mund të flasë për cilësitë tuaja të mira personale. Puna vullnetare është një mënyrë e mirë për të marrë referenca që mund të garantojnë ndershmërinë, besueshmërinë dhe natyrën e mirë.</p>

<p>Pikat kryesore</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bëni kërkime për punë në uebsajtet më të përshtatshme 2. CV-ja duhet të jetë e shkurtër dhe pa gabime drejtshkrimore 3. Aftësitë e transferueshme konsiderohen të rëndësishme në MB. Mendoni se cilat janë pikat tuaja personale të forta dhe të dobëta.
------------------------------	--

Lidhje dhe burime të dobishme

Ka qindra udhëzues se si të aplikoni për punë në MB. Disa nga shembujt më të mirë janë

- [Paketa orientuese për kthimin në punë](#)
- [Paketa orientuese e aplikantit për punë](#)
- Si të shkruani një [letër motivimi](#)
- Disa [shembujt](#) letrave të motivimit
- Disa nga [përfitimet e aftësive të transferueshme](#)
- [20 këshilla për intervista të shkëlqyera](#)
- [Rrjeti i Punësimit të Refugjatëve \(The Refugee Employment Network\)](#) është një rrjet kombëtar anëtarësimi i fokusuar në krijimin e mundësive më të mira të punësimit për refugjatët në të gjithë MB-në. Ka mundësi punësimi që përditësohen rregullisht në uebsajt.